




Prania / Dorezuar Priljena / Prilazno Received / Dohlyety	01. 11. 3	viti god year	
Organ / Njesta Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	6819/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1138/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1138/2023 të datës 04.09.2023 të ankuesit kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme/DMZ, me adresë kundër Vendimit Nr.17/2023 të datës 29.08.2023 të Divizionit të për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1138/2023 e datës 04.09.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.17/2023 i datës 29.08.2023 i Zëvendësueses së Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme më datë 11.07.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Referencë: RN00012041 për grupin Specialist të Përgjithshëm të Shëndetësisë/ Mjekësisë respektivisht për pozitën "Inspektor Shëndetësor", ku afati për aplikim ka qenë nga data 01.08.2023 deri më datë 09.08.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku më datë 21.08.2023 nga Zëvendësuesja e Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit i është refuzuar, aplikacioni për shkak mos plotësimit të kriteret e konkursit gjegjësisht ankuesi nuk e ka dorëzuar dëshminë e kërkuar sipas konkursit pasi përvoja e punës është deklaruar në sektorin privat me të cilën ka qenë e nevojshme një vete deklaram i nënshkruar se ai nuk ka ndonjë mase disiplinore në fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtar Publik.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 21.08.2023 ka parashtruar ankesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa, më datë 29.08.2023 përmes vendimit me numër 17/2023 Zëvendësuesja e Udhëheqëses e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP, ka refuzuar ankesën e ankuesit si te pa bazuar.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.17/2023 të datës 29.08.2023 të Zëvendësueses së Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP, më datë 04.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5939/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor se ankuesi i ka bashkangjitur te gjitha dokumentacionet nga shkollimi i mesëm deri tek ai specialistik, ku ka dorëzuar dokumente me shume se që është kërkuar në konkurs.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 11.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor. Ndërsa Këshilli me datë 15.09.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 5939/2023 të datës 04.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës të datës 04.09.2023; Vendimin me numër 17/2023 të datës 29.08.2023 të DMZP-së; Vendimin me numër 03/2023 të datës 21.08.2023 të DMZP-së; Certifikatën e datës 29.06.2022 të Odës Stomatologjike të Maqedonisë dhe Shoqatës Stomatologjike Shqiptare për Certifikatën e muajit prill 2023 të "Implatçhone" për Certifikatën e datës 19-21.11.2021 të Certifikatën e datës 15-16.11.2019 të Certifikatën e datës 27-29.10.2017 të Certifikatën e datës 09-11.05.2019 të Certifikatën e datës 01.05.2018 të "KEVP" për Certifikatën e datës 27-29.10.2017 të Shoqatës së Stomatologëve të Republikës së Kosovës për Certifikatën 28-29.04.2018 të Stomatologjisë së Avancuar për Certifikatën 9-11.2019 të "Bass Congress" për Certifikatën e Universitetit të Mjekësisë në Tiranë për Licencën e punës me numër KO-03553-02-42 të datës 09.08.2022 të lëshuar nga Oda e Stomatologëve të Kosovës për Njoftimin e datës 28.05.2019 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MSH; Licencën e punës me numër KO-03553-02-42 të datës 08.08.2017 të lëshuar nga Bordi Qendror për Regjistrim dhe Licencim i Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimin me numër protokoli 2952 të datës 09.06.2023 të Odës Stomatologjike të Kosovës; Vendimin me numër protokoli 05-5120 të datës 04.09.2015 të Ministrisë së Shëndetësisë; Diplomën me numër 960 të datës 22.02.2005 të Universitetit të Prishtinës- Fakulteti i Mjekësisë për Certifikatën mbi dënimet penale të datës 28.07.2023 të Sistemit qendror të evidencës penale të Kosovës; Vendimin me numër 011/2011 të datës 19.01.2011 të Komunës së Hanit të Elezit; Certifikatën e datës 6-7.11.2019 të Institutit të Kosovës për Administratë Publike për Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 07.08.2023 të Ministrisë së Shëndetësisë për Diplomën me numër protokoli 321 të datës 02.06.1994 të SH.M "Skënderbeu" Han i Elezit për Kopjen e letërnjoftimit të Ankesën e parashtruar nga Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.09.2023 të KPMSHCK për MPB; Përgjigjen në ankesë me numër protokoli 1138/2023 të datës 15.09.2023 të MPB për KPMSHCK; Njoftimin 21.08.2023 të DMZP-MPB; Shpalljen e konkursit me numër reference RN00012041 të datës 11.07.2023 nga MPB për emrin e grupit

"Specialist i përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë" për pozitat "Inspektor shëndetësor; Kontratën mbi zbatimin e shkollimit specialistik të datës 01.09.2014 nga Ministria e Shëndetësisë; Certifikatën e datës 28-29.2018 nga Stomatologjia e Avancuar; Certifikatën e datës 27-29.10.2017 nga Shoqata e Stomatologëve të Republikës së Kosovës; Certifikatën e datës 11.10.2017 nga "KEVP"; Rekomandimin e datës 01.07.2001 nga "The Forum"; Vendimin me numër 9661/2017 të datës 21.12.2017 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Hanit të Elezit; Akt emërimit me numër 189 të datës 08.07.2019 të _____ nga Ministria e Shëndetësisë; Emalin e datës 01.11.2023 të _____ drejtuar KPMSHCK-së Emalin e datës 01.11.2023 të _____
Drejtuar _____

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.17/2023 të datës 29.08.2023 të Zëvendësueses së Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP, më datë 04.09.2023 ka parashtruar ankesë më numër protokolli 5939/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor se ankuesi i ka bashkangjitur të gjitha dokumentacionet nga shkollimi i mesëm deri tek ai specialistik, ku ka dorëzuar dokumente me shumë se që është kërkuar në konkurs.

Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin Nr. Referencë: RN00012041 për grupin *Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë* respektivisht për pozitën *Inspektor i Shëndetësisë*, kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fushat; Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi tjetër dhe Menaxhim Mjekësore;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin qe dëshmon se diploma e marre jashtë vendimit është ne procedure te nostrifikimit; Kopjen e dëshmisë se punësimit te bashkangjitur se paku një dëshmi mbështetëse si ne vijin:, pasqyrën pagesave te fondit te kursimeve pensionale ; kopjen e licencës për ushtrim te pavarur te veprimtarisë shëndetësore; Kopjet e dëshmisë se trajnimeve te ndjekura apo trajnimeve qe aplikuesi i ka realizuar ne cilësinë e trajnuesit; Dëshmi mjekësorë se kandidati është ne gjendje shëndetësore për te kryer detyrat; Certifikatën /vërtetimin nga Gjykata ose Këshilli Gjyqësore i Republikës se Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim te formës se prere për kryerjen e një vepre penale me dashje jo me te vjetër se gjashte (6) muaj nga data e lëshimit; ; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e punës, është ne sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me te cilin dëshmohet se ai nuk ka një mase disiplinore ne fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik te pushuar sipas ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik; Nëse përvoja e punës e deklaruar është ne sektorin privat brenda apo jashtë vendit ne një OJQ brenda apo angazhimi nga i cili rrjedhe përvoja e punës ne ndonjë forme e marrëdhënies kontraktuale qe nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vete deklarim i nënshkruar se ajo nuk ka një mase disiplinore ne fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik te pushuar sipas ligjit NR.06/L për zyrtar Publik.*

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafin 1, përcaktohet se: *“Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”,* ndërsa sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion”*.

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, e që kanë të bëjnë me kërkesat për pranim në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave të lëndës, ankuesi aktualisht nuk është duke ushtruar ndonjë pozitë të zyrtarit publikë/shërbimit civil, mirëpo sipas provave të lëndës konkretisht dokumentacionin që ka dorëzuar ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedh se i njëjti nga data 01.03.2005 deri më datë 30.11.2017 ka punuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Han të Elezit në pozitën e Stomatologut, nga data 19.01.2011 i njëjti është caktuar Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Menduh Kaloshi” në Han të Elezit, ndërsa nga data 08/07/2019 deri me datë 10.11.2022 ka punuar në Ministrinë e Shëndetësisë në pozitën Inspektor Shëndetësor, andaj edhe përkundër kësaj se i njëjti ka punuar në pozitë të zyrtarit publikë/shërbimit civil nuk ka ofruar vërtetim nga institucioni ku ka punuar apo një vete deklaram të nënshkruar nga ai me të cilin dëshmohet se ai nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi, me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka dorëzuar edhe dëshmi tjera për përvojën e punës, konkretisht Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 07.08.2023 të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë me të cilën përveç që ka dëshmuar përvojën e punës ka dëshmuar se nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, mirëpo të njëjtën nuk e ka dorëzuar me rastin e aplikimit për emrin e grupit „Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë” respektivisht për pozitën „Inspektor i Shëndetësisë” të shpallur sipas konkursit të datës 11.07.2023 me numër referencë: RN00012041 nga Ministria e Punëve të Brendshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku ky fakt është vërtetuar edhe në bazë të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht në bazë të aplikacionit të tij po ashtu edhe në bazë të emalit të datës 01.11.2023 të dërguar nga zyrtarja e DMZP-së e cila ka deklaruar se ankuesi me rastin e aplikimit nuk i ka bashkëngjitur dokumentet të cilat nevojiten për të dëshmuar se i plotëson kriteret e konkursit dhe po ashtu i njëjti nuk i ka bashkëngjitur edhe me rastin e parashtrimit të ankesës.

Nisur nga baza ligjore e përmendur si më lartë dhe nga vlerësimi i provave të lëndës, respektivisht dëshmitë e dërguar nga ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedh se ankuesi nuk ka

përmbushur kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak ngase nuk ka dëshmuar me prova materiale Dëshminë se nuk ka mase disiplinore ne fuqi për largim nga pozita e zyrtarit publik, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi DBNJ Nr.17/2023 i datës 29.08.2023 i Zëvendësueses së Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse i njëjti është nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3, nenin 15 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimi si më lartë, thekson faktin se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga e drejta për t'iu nënshtruar procedurave të tjera të pranimit ngase obligimi për të dorëzuar dokumentacionin së bashku me aplikacionin është obligim i kandidatit, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuara për shkak që nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe faktike, sepse refuzimi i aplikacionit të ankuesit nuk është bërë për shkak të mos plotësimit të kriterëve në aspektin e përgatitjes profesionale apo në aspektin e mos përmbushjes së përvojës së punës por është bërë vetëm që nuk ka dorëzuar dëshminë e cekur si ma lartë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda më numër , A.nr.1138/2023,

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.